



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1567/1 Prot

Tiranë, më 20.11.2019

V E N D I M

Nr.139, datë 20.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Librazhd, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Librazhd,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Librazhd.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Librazhd, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 3, datë 03.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Librazhd,

“Për ekzekutimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 91, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe institucioneve në varësi, strukturës organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Librazhd për vitin 2019”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Librazhd së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **61** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i nivelit të lartë drejtues, **4** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **17** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **39** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Librazhd, Komisioneri ka evidentuar pozicione pune, të cilat për nga emërtesa konsiderohen si pozicione të shërbimit civil, për faktin se në strukturë shoqërohen me emërtesën *“Specialist”* ose *“Inspektor”*. Konstatohet se, këto pozicione, pavarësisht emërtesës, janë trajtuar nga njësia përgjegjëse si funksione administrative, jashtë shërbimit civil, nisur nga kompetencat dhe detyrat funksionale që ato kryejnë, si dhe kategorisë së pagës aplikuar për këto pozicione.

Njëkohësisht, është konstatuar se, disa pozicione pune, të cilat sipas strukturës janë klasifikuar si pozicione të shërbimit civil, nuk rezultojnë të jenë emërtuar sipas kërkesave të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të tilla si pozicionet e punës me emërtesën *“Sportelist, në Qendrën Kombëtare të Biznesit” (2 pozicione pune)* dhe *“Administrator i Ndhmës Ekonomike”*, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale (*1 pozicion pune*).

Në kuptim të ligjit për nëpunësin civil, si dhe si dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, me miratimin e strukturës së ardhshme të institucionit, pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksione administrative, nuk duhet të shoqërohen me emërtesën *“Specialist”* ose *“Inspektor”*, me qëllim diferencimin e tyre nga pozicionet e shërbimit civil.

Më tej, në lidhje me pozicionet e punës *“Sportelist, në Qendrën Kombëtare të Biznesit”* dhe *“Administrator i Ndhmës Ekonomike”*, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, njësia përgjegjëse e Bashkisë Librazhd, me miratimin e strukturës së ardhshme, duhet të analizojë detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse për pozicionet e mësipërme, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil.

Në vijim të analizës së strukturës organizative të Bashkisë Librazhd, Komisioneri konstaton disa parregulsi në mënyrën e organizimit të disa prej njësive organizative të institucionit, të cilat konsistojnë në:

Së pari, vërehet se, në përbërje të njësisë organizative me emërtesën “*Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit*”, janë përfshirë pozicionet e punës “*Inspektor mjedisi*” dhe “*Inspektor*” (pozicione të cilat nga njësia përgjegjëse janë trajtuar si pozicione të shërbimit civil), të cilat nuk kanë lidhje me funksionet që realizon kjo njësi. Për këtë arsye, këto pozicione pune, me miratimin e strukturës së ardhshme, duhet të përfshihen në një nga njësitë organizative të këtij institucioni, pozicionet e së cilës për nga funksionet dhe kompetencat janë të ngjashme me të.

Së dyti, konstatohet se, pozicionet e punës, pjesë e njësisë organizative “*Zyra me një ndalesë*”, janë trajtuar si pozicione të shërbimit civil. Në këtë njësi organizative përfshihen **3** pozicione pune, konkretisht: a) *Përgjegjës i Zyrës*, b) *Specialist i zyrës me një ndalesë*, c) *Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik*.

Në nenin 2, pika “e”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përcaktohet se pozicionet e punës që ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për të tretë, përjashtohen nga skema e shërbimit civil. Në këto kushte, nisur nga natyra e punës dhe detyrave që realizohen nga këto funksione, të cilat kanë karakter shërbimi, njësia përgjegjëse e Bashkisë Librazhd, në strukturën e ardhshme të institucionit, duhet t’i përjashtojë këto pozicione nga fusha e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, si dhe të evitojë në të njëjtën kohë përdorimin e emërtesës “*Specialist*”, për këto pozicione pune.

Ndërsa, në lidhje me pozicionin e punës “*Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik*”, i cili aktualisht trajtohet si pozicion i shërbimit civil, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masa për përfshirjen e këtij pozicioni në një njësi tjetër organizative, pozicionet e së cilës për nga funksionet dhe kompetencat janë të ngjashme me të.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **22** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **30** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë së aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure të rregullt konkurrimi, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, ndërsa **9** pozicione të shërbimit civil rezultuan të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, “*Specialist*”, në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 331, datë 03.06.2019;
2. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, i Sektorit të Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 81, datë 15.12.2016;
3. *****, “*Specialist i burimeve njerëzore, protokollit dhe sekretarisë*”, emëruar me urdhrin nr. 656, datë 16.10.2017;
4. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 730, datë 30.10.2018;
5. *****, “*Specialist llogaritare – arkëtare*”, në Sektorin e Financës (mungon akti i emërimit);
6. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 444, datë 07.06.2018;
7. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 41, datë 29.01.2019;
8. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 356, datë 02.05.2018;
9. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 42, datë 17.01.2019;
10. *****, “*Administrator i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 165, datë 23.03.2017;
11. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe i Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 682, datë 04.10.2018;
12. *****, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 04.03.2016;
13. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 557, datë 15.09.2017;
14. *****, “*Specialist shërbimesh*”, në Sektorin e Projektive, Shërbimeve, Strehimit dhe Investive, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 697, datë 11.10.2018;
15. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Projektive, Shërbimeve, Strehimit dhe Investive, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 781, datë 05.12.2017;
16. *****, “*Inspektor mjedisi*”, në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 57, datë 12.01.2018;
17. *****, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 8, datë 04.01.2018;

18. ***** , “*Specialist i mbrojtjes së tokave bujqësore*”, në Sektorin e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave Bujqësore, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 614, datë 11.09.2018;
19. ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Prodhimit, Menaxhimit të Ujitjes dhe Turizmit, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 238, datë 05.04.2016;
20. ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Prodhimit, Menaxhimit të Ujitjes dhe Turizmit, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 613, datë 10.09.2018;
21. ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit dhe Shërbimit Veteriner, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 35, datë 03.02.2017;
22. ***** , “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 11.04.2014;;
23. ***** , “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, emëruar me urdhrin nr. 19, datë 11.11.2008;
24. ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Njësinë për Koordinimin e Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj, emëruar me urdhrin nr. 551, datë 01.10.2019;
25. ***** , Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 245, datë 11.04.2016;
26. ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 382, datë 10.07.2017;
27. ***** , “*Specialist i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 43, datë 04.02.2016;
28. ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 206, datë 27.03.2019;
29. ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 32, datë 08.02.2016;
30. ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 223, datë 07.03.2018.

Komisioneri konstaton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në

fuqi, ç'ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Librazhd, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III,

“Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Librazhd, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **30** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:

- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 331, datë 03.06.2019;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, i Sektorit të Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 81, datë 15.12.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i burimeve njerëzore, protokollit dhe sekretarisë*”, emëruar me urdhrin nr. 656, datë 16.10.2017;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Buxhetit, emëruar me urdhrin nr. 730, datë 30.10.2018;
- ✓ ***** , “*Specialist llogaritave – arkëtare*”, në Sektorin e Financës (mungon akti i emërimit);
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 444, datë 07.06.2018;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 41, datë 29.01.2019;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 356, datë 02.05.2018;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Taksave, Tarifave Vendore dhe Tregut, emëruar me urdhrin nr. 42, datë 17.01.2019;
- ✓ ***** , “*Administrator i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 165, datë 23.03.2017;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe i Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 682, datë 04.10.2018;
- ✓ ***** , Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 04.03.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektive, Shërbimeve, Strahimit dhe Investive, emëruar me urdhrin nr. 557, datë 15.09.2017;

- ✓ *****; “*Specialist shërbimesh*”, në Sektorin e Projektimeve, Shërbimeve, Strehimit dhe Investimeve, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektimeve, Shërbimeve, Strahimit dhe Investimeve, emëruar me urdhrin nr. 697, datë 11.10.2018;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Sektorin e Projektimeve, Shërbimeve, Strehimit dhe Investimeve, në Dretorinë e Planifikimit, Territorit, Projektimeve, Shërbimeve, Strahimit dhe Investimeve, emëruar me urdhrin nr. 781, datë 05.12.2017;
- ✓ *****; “*Inspektor mjedisi*”, në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit, emëruar me urdhrin nr. 57, datë 12.01.2018;
- ✓ *****; Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 8, datë 04.01.2018;
- ✓ **Ervin Qatja**, “*Specialist i mbrojtjes së tokave bujqësore*”, në Sektorin e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave Bujqësore, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 614, datë 11.09.2018;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Sektorin e Prodhimit, Menaxhimit të Ujitjes dhe Turizmit, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 238, datë 05.04.2016;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Sektorin e Prodhimit, Menaxhimit të Ujitjes dhe Turizmit, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 613, datë 10.09.2018;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit dhe Shërbimit Veteriner, në Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ushqimit, emëruar me urdhrin nr. 35, datë 03.02.2017;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 11.04.2014;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, emëruar me urdhrin nr. 19, datë 11.11.2008;
- ✓ *****; “*Përgjegjës Sektori*”, në Njësinë për Koordinimin e Integritimit Europian dhe Ndihmës së Huaj, emëruar me urdhrin nr. 551, datë 01.10.2019;
- ✓ *****; Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 245, datë 11.04.2016;
- ✓ *****; “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 382, datë 10.07.2017;
- ✓ *****; “*Specialist i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 43, datë 04.02.2016;
- ✓ *****; “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, emëruar me urdhrin nr. 206, datë 27.03.2019;

- ✓ *****; “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 32, datë 08.02.2016;
 - ✓ *****; “Specialist”, në Sektorin e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 223, datë 07.03.2018.
2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit aktualisht janë vakante ose rezultojnë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
 3. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
 4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Librazhd, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:
 - ✓ Të evitohet përdorimi i emërtesave “Specialist” ose “Inspektor”, për pozicione pune të cilat nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil;
 - ✓ Për pozicionet e punës, të cilat në strukturë paraqiten me emërtesën “Sportelist, në Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe “Administrator i Ndihmës Ekonomike”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, të analizojë detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil;
 - ✓ Për pozicionet e punës “Inspektor” dhe “Inspektor mjedisi”, të cilat sipas strukturës aktuale aktuale përfshihen në njësinë organizative “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit”, të marrë masa, që me miratimin e strukturës së ardhshme t’i përfshijë në një njësi tjetër organizative, me të njëjtën natyrë të funksioneve që kanë të bëjnë më këto pozicione;
 - ✓ Për pozicionet e punës në përbërje të “Zyrës me një ndalesë”, të përcaktojë regjimin juridik të marrëdhënies së punësimit, si punonjës shërbimi, duke evituar në të njëjtën kohë përdorimin e emërtesës “Specialist” për këto pozicione pune;

- ✓ Për pozicionin e punës “*Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik*”, i cili sipas strukturës aktuale përfshihet në njësinë organizative “*Zyra me një ndalesë*”, njësia përgjegjëse, të marrë masa, që me miratimin e strukturës së ardhshme ta përfshijë në një njësi tjetër organizative, me të njëjtën natyrë të funksioneve që ka të bëjë me këtë pozicion.
- 5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 81, datë 18.04.2016, të Komisionerit “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me urdhrin nr. 334 prot., datë 18.04.2016*” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
- 6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Librazhd, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
- 7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
- 8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Librazhd, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Librazhd dhe Ministria e Brendshme. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Librazhd të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha